



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5136 Prot.

Roskovec, më 21, 07 2021

VENDIM

Nr. 54, Datë 21, 07, 2021

PËR MIRATIMIN E FUSHATËS SË PARTNERITETIT TË KËSHILLIT TË BASHKISË  
ME QYTETARËT

Bazuar në ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 16, pika 1, neni 18, neni 19 dhe neni 54, pika k, ligjit 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" dhe Rregullores së Këshillit Për marrëdhëniet me Publikun dhe Mediat (Konsultimeve Publike) me propozim të Kryesisë së Këshillit, Këshill i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Miratim të zhvillimit të aktivitetit "**Fushata e Partneritetit të Këshillit me qytetarin**".
2. Aktiviteti do të zhvillohet sipas programit të detajuar bashkangjitur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Këshilli Bashkiak, Kryetari i Këshillit, Sekretariati dhe komisionet e Këshillit Bashkiak të mbështetura nga specialistët e administratës së Bashkisë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi në bazë të ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 55 pika 6.

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

PROGRAMI I DETAJUAR PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETIT

“Fushatën e partneritetit të këshillit me qytetarin”.

**Të nderuar!**

Këshilli i Bashkisë me qëllim garantimin e bashkëqeverisjes me komunitetin, në respekt të besimit të dhënë nga banorët dhe në zbatim të dispozitave ligjore, konsideron të domosdoshme përfshirjen e qytetarëve në qeverisjen lokale si mënyra më e mirë për të siguruar qeverisje të suksesshme, me mbështetjen dhe asistimin e projektit „Bashki të Forta“, financuar nga Qeveria Zviceriane në bashkëpunim me Shoqatën e Qarqeve të Shqipërisë, inicion „Fushatën e partneritetit të Këshillit me Komunitetin/qytetarin“.

Ky aktivitet fillon si fushatë për të vazhduar si një aksion i përhershëm për gjithë aktivitetin e Këshillit të Bashkisë.

Për realizimin e këtij qëllimi, duke ndërtuar mbi avantazhet e zhvillimit teknologjik (instrumentat dixhital mundësojnë komunikim të shpejtë, mbulim të gjerë me kosto minimale) synohet që kjo fushatë të ndërmarrë veprime konkrete për ngritjen e urave të komunikimit të komunitetit me qeverisjen lokale dhe konkretisht me Këshillin e Bashkisë si organ përfaqësues.

Me anën e këtyre veprimeve në sitet(ëeb) e internetit dhe rrjetet sociale synojmë të ngrejmë rrugë të thjeshta dhe transparente për komunikim me qytetarët.

Për këtë qëllim është e nevojshme që përveç realizimit të platformave virtuale në siten (ëeb) e Këshillit dhe ngritjes së faqeve në rrjetet sociale, kërkohet nxitja e përfshirjes së qytetarëve për t'u bërë përdorues të këtyre mjeteve dhe rrjedhimisht edhe aktivë në bashkëqeverisje.

Për të ndihmuar në nxitjen dhe rritjen e besimit të komunitetit në këto mjete të reja komunikimi do ndërmerren veprime konkrete, të cilat sigurojnë transparencën e vendimeve të Këshillit dhe sidomos të mendimeve dhe sugjerimeve të qytetarëve të marra përmes kanaleve virtuale të ndërveprimit këshill-qytetar.


Më poshtë po paraqesim planin e detajuar me veprimet konkrete për realizimin e kësaj fushate:




Nr.	Aktiviteti	Personi përgjegjës	Afati	Sqarim
1.	Ndërtimi i ndërfaqes së Këshillit të Bashkisë			
1.1	<p>Ngritja e rubrikave në ndërfaqe për publikimin e:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njoftime</li> <li>- projekt vendimeve</li> <li>- vendimeve,</li> <li>- raporteve të transparencës</li> <li>- informacioneve</li> <li>- komisionet e Këshillit</li> <li>- listën e anëtarëve të Këshillit dhe kontaktet e tyre.</li> <li>- kryetarët e strukturave komunitare dhe kontaktet e tyre</li> <li>- proces verbalet.</li> <li>- rregulloret e Këshillit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sekretari</li> <li>- IT</li> </ul>		<p>Ky aktivitet realizohet ne bashkëpunim me IT e Bashkisë i cili mirëmban faqen e Bashkisë duke hapur rubrikat e cilësuar dhe duke udhëzuar sekretarin për të hedhur materiale në cdo rubrike. Mirëmbajtja dhe azhonimi periodik është detyrë e sekretariatit.</p> <p>Një plan i detajuar është hartuar (apo do të hartohet) në trajnimet që po ofrohen nga Shoqata e Qarqeve me asistencë të projektit Bashki të Forta (projekt i qeverisë së Zvicrës)</p>
1.2	<p>Ndërtimi në ndërfaqen e Këshillit të rubrikës për ankesat/kërkesat dhe iniciativat/peticionet qytetare ku do përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Formatet e ankesës/kërkesës dhe iniciativës/peticionit (në format të shkarkueshëm (printueshëm) dhe plotësimi online (ku është e mundur).</li> <li>- Regjistri i ankesave dhe kërkesave me të dhëna të azhonuara për cdo ankesë ose kërkesë.</li> <li>- Regjistri I Peticioneve dhe iniciativave.</li> <li>- Shpjeguesë të thjeshtëzuar për procedurën e ankesave dhe plotësimin e formularëve si dhe ku mund të merren sqarime të detajuara.</li> <li>- Dhënia e mundësisë së adresimit të çdo shqetësimi, sugjerimi të qyterarëve online dhe trajtimi me transparencë i sugjerimeve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sekretariati/Sekretar</li> <li>- i</li> <li>- IT</li> </ul>		<p>Procesi është përsëri teknik dhe kërkon angazhim të IT-së për vënien në funksionim dhe më pas azhonim të të dhënave nga sekretariati/sekretari.</p>
1.3	Ndërtimi I rubrikës për dëgjosat dhe	- Sekretariati/Sekretar		Aktiviteti parashikon punë të vazhdueshme



Nr.	Aktiviteti	Personi përgjegjës	Afati	Sqarim
	<p>konsultimet publike si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Regjistri I konsultimeve publike me të dhëna për çdo process konsultimi para vendimarrjes me detajet e përcaktuara në rregulloren e konsultimeve publike të këshillit.</li> <li>- Realizimi i sondazheve on-line për çështje: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sondazhi i prioriteve të buxhetit për vitin pasardhës (fillon në 3 mujorin e parë të vitit dhe përfundon në 3 mujorin e fundit)</li> <li>- Sondazhi për matjen e kënaqshmërisë së komunitetit mbi shërbimet publike.</li> </ul> </li> <li>Sondazhi mund të qëndrojë I hapur gjithnjë si një matës në kohë I cilësisë dhe nivelit të shërbimeve (fillojmë pilotimin me shërbime të ndjeshme për qytetarët si ai i mbetjeve, asrimit parashkollor etj.).</li> <li>- Sondazhe me tema specifike për çështje të vendimarrjes në kuadër të konsultimeve publike para vendimarrjes por edhe për tema në interes të Këshillit si performance e këshillit etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>i</li> <li>- IT</li> <li>- Komisionet</li> <li>- Këshilltarët</li> </ul>		<p>për hartimin e sondazheve dhe është e nevojshme mbështetje e IT. Gjithësesi formulimet e sondazheve duhet të përgatiten/dakrotësohen nga komisionet sipas tematikës dhe teknikisht përdoren platform të thejshta si <i>google forms</i> dhe <i>forms office (pa kosto)</i>. Për nxitjen e qytetarëve për plotësimin e sondazheve kërkohet angazhim I gjithë këshilltarëve dhe do përdoren dhe format e nxitjes të sqaruara më poshtë.</p>
2.	<p>Ngritja dhe përdorimi I rrejteve sociale facebook, instagram etj si (fanpage) për Këshillin e Bashkisë ku të bëhet publikimi I çdo njoftimi që publikohet në ndërfaqen e Këshillit si dhe të promovohen rubrikat e tjera apo sondazhet e Këshillit, si dhe sigurohet shfaqja e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak (përfshi arkivën dixhitale të këtyre mbledhjeve)</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sekretariati/sekretari</li> <li>- IT</li> </ul>		<p>Aktiviteti praktikisht kërkon hapjen e fanpage-s në rrjete të ndryshme me ndihmën edhe te IT dhe më pas ndërfaqja e internetit të këshillit jep mundësinë e publikimeve automatike në pjesën më të madhe të rrjeteve sociale. Realisht këto rrjete do jenë urrat më të mira të lidhjes së komunitetit me ndërfaqen e Këshillit.</p> <p>Një plan i detajuar për menaxhimin e rrjetit</p>



Nr.	Aktiviteti	Personi përgjegjës	Afati	Sqarim
3.	Realizimi I spotit video per nxitjen dhe informimin e komunitetit mbi sondazhet dhe format e ndërveprimit të tyre me Këshillin e Bashkisë. Spoti I realizuar transmetohet në media dhe në rrjetet sociale.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kryetari</li> <li>- Kontraktor</li> </ul>		<p>social fb është hartuar (apo do të hartohet) në trajnimet që po ofrohen nga Shoqata e Qarqeve me asistencë të projektit Bashki të Forta (projekt i qeverisë së Zvicrës).</p> <p>Për të realizuar këtë veprim duhet të realizohet një spot video I cili të ketë në qëndër partneritetin Këshill-Komunitet me qëllim nxitjen e banorëve për të përdorur rubrikat dhe platformat e komunikimit dhe informimin për mënyrat e përdorimit dhe anëtarësimin e banorëve në fanpag-et e rrjeteve sociale dhe ndërfaqen e Këshillit. Ky spot realizohet nga kontraktorë profesionistë dhe paguhet nga fondi I këshillit për mediat.</p> <p>Për të incentivuar këtë përpjekje të parë, Bashki të Forta do të asistojë Këshillin Bashkiak.</p>
4.	<p>Realizimi I publikimeve të shkruara për shpërndarje në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Këndet e njoftimeve publike.</li> <li>- Parqe dhe ambjente publike të frekuentuara nga banorët.</li> <li>- Sheshe të fshatrave.</li> <li>- Ambjente të shkollave të mesme.</li> <li>- Në banka, posta, sportele shërbimi etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sekretariati</li> <li>- Specialist I bashkisë</li> <li>- Administratorët</li> <li>- Këshillat</li> <li>- Fshatrave</li> </ul>		<p>Veprimi parashikon realizimin e fletëve të vogla sqaruese të cilat publikohen në ambjentet e cituara dhe përmban mesazhe sensibilizuese dhe informuese për qytetarët për mënyrën se si mundet të përdorin plantformat virtuale dhe rrjetet sociale duke u bërë pjesë e bashkëqeverisjes. Për sondazhet e publikuara duhet të realizohen publikime të tilla me temën specifike për të nxitur banorët të plotësojnë sondazhin respektiv. Mundet të përdoren edhe barcodet për aksesim të fanpag-eve të rrjeteve sociale apo aksesimin e ndërfaqeve dhe sondazheve të ndyshme. Shembull:</p>

Nr.	Aktiviteti	Personi përgjegjës	Afati	Sqarim
5.	Realizimi I takimeve të hapura me publikun për tema të caktuara.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Komisionet</li> <li>- Kryetari</li> <li>- Sekretariati</li> <li>- Komisioni I Barazisë Gjinore</li> <li>- Aleanca e Grave</li> <li>- Këshilltaret</li> </ul>		<p><b>Barcod I per Sondazhin e Këshillit të Bashksië Pogradec për prioritetet.</b></p>  <p>Pavarësisht rrugëve virtuale të komunikimit të cilat të japin mundësi të shumta me pak shpenzime, komunikimi nëpërmjet takimeve fizike duhet të përdoret sidomos duke konsideruar grupmoshat, por dhe vendodhjen e anëtarëve të komunitetit ku shpesh është e vështirë që këto kategori të jenë përdorues të mjeteve teknologjike për të aksesuar komunikimin virtual. Në këtë kuptim takimet fizike janë një urë e mirë ndërveprimi dhe japin mundësi për ndërveprim më të mirë. Këto aktivitete duhet të realizohen më pajtë të rastet e buxhetimit dhe prioritetëve por edhe sa herë është e nevojshme për vendimarrje të caktuara. Procedurat dhe mënyrat janë të sqaruara qartë në Rregulloren e Këshillit për konsultimin publik si dhe në materialet trajnuese të shpërndara nga projekti Bashki të Forta me gjithë Këshillat. Aleanca e Grave Këshilltare ka përgatitur një Plan të Detajuar për përfshirjen e Komunitetit në përputhje me prioritetet e veta (i) shërbimet sociale, (ii) fuqizimin ekonomik të grave dhe</p>

Nr.	Aktiviteti	Personi përgjegjës	Afati	Sqarim
6.	Ditët e publikut	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Komisionet</li> <li>- Kryetari</li> <li>- Sekretariati</li> <li>- Administrata (me kërkesë)</li> </ul>		<p>vajzave, (iii) nisma të buxhetuara gjinore.</p> <p>Në mënyrë që grupet e interesit të komuniteteve që ne përfaqësojmë të njihen me mundësitë që ofron këshilli për qytetarët (dhe në kuadër të kalendarit të buxhetit) sikundër të angazhuar për të sjellë fakte mbi raste të suksesshme të ndërveprimit mes Këshillit dhe qytetarëve, Këshilli përveç spotit informues do të organizojë Ditët e Publikut (në formën e një toën hall).</p> <p>Një axhendë paraprake e Ditës së Publikut është zhvilluar gjatë ESh të organizuara nga Shoqata e Qarqeve me mbështetje të Projektit Bashki të Forta (projekt i qeverisë së Zvicrës).</p> <p>Këshilli mobilizon buxhetin e tij për realizimin e kësaj ngjarjeje.</p>

Realizimi I këti programi kërkon angazhim jo vetëm të personave përgjegjës të cituar por të gjithë këshilltarëve të cilët janë të fuar të monitorojnë zbatimin e këtij programi si dhe duke nxitur qytetarët të përdorin gjithë mënyrat e mësipërme pasi vetëm kështu do të mundemi të sigurojmë suksesin e kësaj fushate të ndërmarrë.

Preqyesi kryesor I kësaj fushate është I matshëm duke analizuar përdoruesit e mjeteve të mësipërme nga ana e komunitetit.

Për ecëurinë e këtij programi raportohet në këshill .Raportimi pas paraqitjes në këshill publikohet në ndërfaqen e Këshillit.

Ju falënderit.

